



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 24/2017 “PËR  
ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE TË KULLIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “b”, fjalët “drejtorive të ujitjes dhe kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.
2. Në shkronjën “ç”, fjalët “te drejtoritë e ujitjes dhe kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

**Neni 2**

Në nenin 2, pika 3, fjalët “Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

### Neni 3

Në nenin 5, pika 2, fjalët “Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit kryejnë” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit kryen”.

### Neni 4

Neni 6 ndryshohet, si më poshtë:

#### “Neni 6

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e ministrisë

1. Ministria ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) përcakton politikën kombëtare të ujitjes dhe të kullimit;
- b) mbikëqyr funksionimin dhe veprimtarinë e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit;
- c) mbikëqyr infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit nga ana teknike;
- ç) propozon krijimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit;
- d) këshillon e udhëzon Agjencinë e ujitjes dhe kullimit, bashkitë dhe organizatat për çështje ligjore, teknike e financiare;
- dh) kryen kontrole financiare të Agjencisë së ujitjes dhe kullimit;
- e) ndërmerr veprime të nevojshme në rast thatësire të zgjatur dhe përmbytjeje;
- ë) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Rregulla dhe kritere teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

### Neni 5

Në nenin 7, pika 1, fjalët “administrohen nga drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “administrohet nga Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

### Neni 6

Në nenin 8, pika 4, fjalët “Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

### Neni 7

Në nenin 9, pika 1, shkronja “a”, fjalët “drejtorisë së ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.

### Neni 8

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.
2. Në pikën 3, fjalët “Çdo drejtori e ujitjes dhe e kullimit dhe bashki merr” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit dhe bashkitë marrin”.

#### Neni 9

Në nenin 11, pika 1, fjalët “drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 10

Në Kreun III, titulli “Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohet me titullin “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 11

Neni 12 ndryshohet, si më poshtë:

#### “Neni 12

#### Krijimi i Agjencisë së ujitjes dhe kullimit

1. Agjencia e ujitjes dhe kullimit krijohet si strukturë në varësi të ministrisë, si person juridik publik, që ka për qëllim të kryejë detyrat e parashikuara në këtë ligj.
2. Agjencia e ujitjes dhe kullimit krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit përcakton:
  - a) organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit;
  - b) vendndodhjen;
  - c) detyra dhe përgjegjësi specifike, përveç sa përcaktohet në nenin 13 të këtij ligji.
4. Agjencia e ujitjes dhe kullimit financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

#### Neni 12

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë :

#### “Neni 13

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë së ujitjes dhe kullimit

1. Agjencia e ujitjes dhe kullimit shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën kryesore të ujitjes dhe kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmytja në administrim të saj, në mënyrë që të plotësojë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë

grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit, si dhe të parandalojë përmbytjen.

2. Agjencia e ujitjes dhe kullimit:

a) kryen kontrollin teknik e fizik të sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytjet;

b) pastron dhe mirëmban kanalet kulluese dhe ujitës;

c) shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit (hidrovoret);

ç) rehabiliton, rikonstrukton dhe ndërton, infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja;

d) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe ndërmerr veprime të nevojshme për të garantuar sigurinë e tyre;

dh) kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së digave të rezervuarëve për ujitje dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja ;

e) merr masa specifike në rast përmbytjeje dhe thatësire të zgjatur;

ë) merr masa për zbatimin e planit periodik dhe të azhornuar të emergjencave nga përmbytja;

f) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;

g) monitoron dhe merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet si dhe të tokave nën sistemin e këtyre ujërave;

3. Agjencia e ujitjes dhe kullimit me urdhër të ministrit, ndërmerr, në raste të veçanta, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e përkohshme të infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja të transferuara bashkisë, në raste të tilla si cenim i sigurisë së digave dhe përmbytje.

4. Veprimtaritë që realizohen nga Agjencia e ujitjes dhe kullimit, sipas këtij neni, financohen nga buxheti i shtetit i miratuar për ministrinë.”.

### Neni 13

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë :

### “Neni 14

#### Organizimi i Agjencisë së ujitjes dhe kullimit

1. Struktura dhe organika e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit miratohet nga Kryeministri, pas propozimit të ministrit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë e ujitjes dhe kullimit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”.

### Neni 14

Në nenin 15, pika 4, fjalët “drejtorinë përkatëse të ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencinë e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 15

Në nenin 20, pika 2, fjalët “drejtorinë e ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencinë e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 16

Në nenin 27, pika 2, fjalët “drejtorinë përkatëse të ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencinë e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 17

Në nenin 32, pika 2, fjalët “drejtorisë së ujitjes dhe kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 18

Në nenin 40 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “Drejtoria e ujitjes dhe e kullimit” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.
2. Në pikën 1, shkronja “a”, fjalët “zonën nën shërbimin e ujitjes dhe të kullimit” zëvendësohen me fjalët “infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja në administrim;”.

#### Neni 19

Neni 41 ndryshohet, si më poshtë:

#### “Neni 41 Llogaritë financiare

Agjencia e ujitjes dhe kullimit, bashkitë dhe organizatat, mbajnë llogari të faturave dhe të shpenzimeve, si dhe përgatisin bilancin vjetor e raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”.

#### Neni 20

Në nenin 42, pika 1, fjalët “çdo drejtorie të ujitjes dhe të kullimit ” zëvendësohen me fjalët “Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 21

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit, ndryshon si më poshtë :

“Regjistri i Agjencisë së ujitjes dhe kullimit, bashkive dhe organizatave”

2. Në pikën 1, fjalët “drejtorive të ujitjes dhe të kullimit ” zëvendësohen me fjalët “Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.

3. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Regjistri i Agjencisë së ujitjes dhe kullimit përmban emrin, vendndodhjen dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja në administrim;”.

#### Neni 22

Në nenin 44, në pikat 1 dhe 2, fjalët “drejtorive të ujitjes dhe të kullimit ” zëvendësohen me fjalët “Agjencisë së ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 23

Në nenin 45, në pikat 1 dhe 2, fjalët “Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit ” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 24

Në nenin 46, pika 2, fjalët “Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit ” zëvendësohen me fjalët “Agjencia e ujitjes dhe kullimit”.

#### Neni 25

Neni 49 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 49

Drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit të krijuara në zbatim të ligjit nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në krijimin e Agjencisë së ujitjes dhe kullimit, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 12, të këtij ligji.”.

#### Neni 26

Në nenin 50, fjalët “administrimin e ujërave” zëvendësohet me fjalën “bujqësinë”.

Neni 27

Neni 51 shfuqizohet.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**